



Shtator / September 2020

shqip

Fal! Jo deri në shtatë herë, por deri në shtatëdhjetë e shtatë herë!

(Mt 18,21)

Kontakt: Meinolf Wacker
Kirchplatz 7
59174 Kamen

Mobil.: +49-172-5638432
Mail: meinolf.wacker@go4peace.eu
Homepage: www.go4peace.eu

Fillo përsëri! Start again!

Të dashur miq të fjalës,

Termometri kishte kaluar 40°. Në një bandë të vogël internacionale po përgatitej muzikë për koncertin final. Talentet në muzikë të secilit individ ishin shumë të ndryshme. Gjithashtu, përpikmëria kishte vlerë të ndryshme tek individë të ndryshëm. Për drejtuesin e kësaj bande ishte një sfidë shumë e madhe. Një mbrëmje, ai tregon: "Në një moment të ditës, kur isha aq i lodhur dhe i zhgënjyer më vinin vetëm lotë. Gjatë gjithë asaj dite kam jetuar moton 'Start again'. Një këngë nuk e kishim ushtruar aq sa duhej – start again! Një pjesmarrës i bandës erdhi vonë në prova dhe ne kishim përfunduar së ushtruar këngën – start again. Mbartësja e notave ra dhe ndërpreu provat – start again. Dhe atëherë kur ndjej se kam dhënë gjithçka dhe nuk di nëse paraqitja jonë do të dalë mirë – start again."

Nuk është e lehtë të mos ngecësh tek gabimet, paragjykimet dhe zhgënjimet për të tjerët. Kjo është një gjë shumë sfiduese për shpirtin. Si do ta ketë përjetuar Pjetri? Ai punonte me vëllezërit e tij Andreasin, Jakobin dhe Gjonin, si një njeri i ashpër. Dy të fundit kishin emrin "Bijtë e bubullimave". Si mund të ketë qenë të punosh në varka në Detin e Galileës, të gjithë mund ta imagjinojnë në imagjinatën e tyre. Shumë fjalë të ashpra dhe të dëmshme do të jenë thënë. Në një moment, Pjetri dukej se ishte mjaftueshem i merzitur dhe prandaj e pyeti Jezusin: "Sa shpesh duhet të fal vëllain tim? Shtatë herë?" Kjo do të ishte shumë! Dhe pastaj ai dëgjon përgjigjen e Jezuit: "Jo shtatë herë, por shtatëdhjetë e shtatë herë!" Pra: falja është një "histori e pafund" me Jezusin! Për të, vlen si vijon: kurrë mos ndaloni së faluri! – Don't stop forgiving!

Ata që jetojnë kështu, çdo ditë, janë lajmëtarë të vërtetë të paqes. Ai gjithmonë i jep një shans paqes! Nëse kemi guximin të mos ndalemi kurrë së heshturi, të fillojmë nga fillimi: **fillo përsëri! Start again!**

për go4peaceTeam

Meinolf Wacker